



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 02 nëntor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCave PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, , Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Armend Zemaj, Adem Grabovci

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm, Dardan Gashi, ministër MMPH,

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19.10.2011,**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,**
- 4. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 19 tetor 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19 tetor 2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, për shkak të mospjesëmarrjes së ministrit në mbledhjen e Komisionit, shtyhet për ditën e premte, datë 04 nëntor 2011, ora 09:00.

3. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i dokumentacionit shtese të MKK lidhur me shqyrtimin e Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të MKK-së, për vitin 2010 dhe tërheqja e dokumentacionit të dorëzuar gabimisht.

Kryetari – Tha se Ministria për Komunitete dhe Kthim ka proceduar dokumentacion shtesë lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të kësaj ministrie, me të cilin dokumentacion ka proceduar material shtesë dhe ka kërkuar që materiali i cili është shqyrtuar në mbledhjen e Komisionit, të mos jetë objekt shqyrtimi meqenëse, ka qenë plan veprimi për rekomandimet e auditorëve të brendshëm, ndërsa tani ministria ka proceduar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it. Propozoi që komisioni të shqyrtoj këtë plan dhe i njëjti t'i procedohet mbledhjes plenare për shqyrtim bashkë me raportin e ZAP-it dhe raportin kthyes të ministrisë. Materiali i proceduar gabimisht nga ministria të mos procedohet në mbledhje plenare.

Ndoshta do të duhej që ZAP-i gjatë dhënies së Opinionit të marrë për bazë që përpos standardeve ndërkombëtare edhe standardet e tjera që has në material. Hap diskutimin.

Zukë Zuka – ZAP- Tha se këtë plan veprimi MKK-ja i ka proceduar edhe ZAP-it menjëherë pas hartimit të raportit final të auditimit dhe në bazë të kësaj mund të thuhet se kjo ministri ka pranuar të gjeturat e ZAP-it, ka marrë parasysh rekomandimet dhe ka paraqitur personat përgjegjës për implementimin e tyre, afatin kohor etj. Pra, në këtë plan është dhënë ideja se çka do të veprohet, por diçka konkrete nuk ka rreth zbatimit të rekomandimeve. Se sa janë zbatuar këto rekomandime, ZAP-i mund të mbikëqyrë atë me raportin e radhës të auditimit të kësaj ministrie.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni duhet ta njoftoj Kuvendin se ZAP-i, Opinionin për këtë ministri e ka dhënë ose të njëanshëm ose të ndikuar politikisht, sepse të gjeturat dhe rekomandimet e ZAP-it që përmban raporti, flasin për diçka tjetër - për një opinion tjetër. Komisioni është i interesuar që të ruaj pavarësinë e ZAP-it, megjithatë duhet ngritur çështja se opinionin për këtë ministri është dhënë në kundërshtim me të gjeturat dhe rekomandimet që përmban raporti.

Valbona Dibra – Propozoi që pika dy e rekomandimit të Komisionit të mbledhjes së datës 19 tetor 2011, të ndryshohet si vijon: “Zyra e Auditorit të përgjithshëm të bëjë auditim të performancës së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim”. Po ashtu ishte e mendimit që Kuvendi duhet ta përkrah

ZAP-in që në përgjithësi të rritet numri i auditimeve të performancës. Kjo do të ishte zgjidhja e problemeve, sepse aty pasqyrohet gjendja reale e institucioneve.

Bali Muharremaj – MKK dhe MMPH kanë probleme serioze dhe Kuvendi i Kosovës urgjentisht duhet të ndërmarrë masa konkrete, sepse gjendja do të përkeqësohet. Prandaj, rekomandimet e Komisionit për mbledhje plenare duhet të jenë konkrete.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Rekomandimi i mbledhjes së datës 19 tetor 2011, procedohet në mbledhje plenare, me këto ndryshime:

Pika dy e rekomandimit ndryshon si vijon “Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditim të performancës të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim”.

Dokumentacioni shtesë, zëvendëson materialin e dorëzuar gabimisht nga MKK-ja.

b). Diskutim rreth propozimit të Grupit punues për hartimin e rekomandimit për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike

Valbona Dibra- Tha se grupi punues edhe pse jo zyrtarisht, ka marrë informacione se Ministria për Zhvillim Ekonomik ka filluar me Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Shprehu shqetësimin se auditori i përgjithshëm ka pas informacione se është bërë plotësim ndryshimi i ligjit dhe se ka dorëzuar në MZHE propozimet e tij, por për këtë nuk e ka informuar komisionin.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje duhet të marrim parasysh edhe faktin që p.sh në rastin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, pronari vendos se kush do të bëjë auditimin e ndërmarrjes e jo ZAP-i. Këto janë çështje që duhet diskutuar pasi që të vendoset lidhur me seancën dëgjimore.

Grupi punues në mbledhjen e mbajtur me datë 31 tetor 2011, ka dal me rekomandimin se Komisioni duhet të organizoj seancë dëgjimore lidhur me auditimin e ndërmarrjeve publike. Të ftuar në këtë seancë të jenë: ministri i ministrisë për Zhvillim Ekonomik, Njësia për Monitorimin e ndërmarrjeve Publike dhe Auditori i përgjithshëm si dhe përfaqësues nga Ndërmarrjet Publike. Propozoi që Komisioni të miratoi këtë rekomandim të Grupit Punues.

Kryetari – Tha se Komisioni nuk ka zyrtarisht informacion se ky plotësim ndryshim i ligjit është në proces. Po ashtu, plotësim ndryshimi i tij, bie në kompetencë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike mundet që shqetësimet e tij t`ja procedoj këtij Komisioni. Por, gjithashtu gjatë shqyrtimit të raportit vjetor të auditimit që do të bëhet në mbledhje plenare, në emër të Komisionit do të ngrit shqetësimin që nevoja për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike është urgjente, meqenëse për Komisionin përzgjedhja e auditorit të jashtëm nga vetë ndërmarrjet publike paraqet konflikt interesi dhe kjo duhet korrigjuar urgjentisht.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni apo edhe grupi i deputetëve, mund të ndërmarrin nismë legjislative, për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Murselj Haljilji- Nuk duhet ngatërruar kompetencat. Nëse Plotësim Ndryshimi i Ligjit për ndërmarrjet Publike bie në kompetencë të Komisionit tjetër parlamentar, atëherë Komisioni mund të ndihmoj, por nuk duhet bërë gara se kush do të bëjë këtë punë. KMFP mund të ndihmoj në këtë drejtim, por jo të udhëheqë me këtë çështje meqenëse kjo është kompetencë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

Kryesuesi Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

- *Refuzohet rekomandimi i Grupit punues për organizimin e seancës dëgjimore lidhur me auditimin e Ndërmarrjeve Publike.*
- *Në mbledhje plenare, kryetari i Komisionit gjatë prezantimit të qëndrimit të Komisionit lidhur me raportin vjetor të auditimit, paraqet edhe shqetësimin e Komisionit se përzgjedhja e auditorit të jashtëm nga vet ndërmarrjet publike përbënë konflikt interesi dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike duhet të ndryshohet, urgjentisht.*

c). Diskutim rreth takimit me Grupin Britanik në Unionin Ndër-Parlamentar

Kryetari - Njoftoj anëtarët e Komisionit se prej datës 14-18 Nëntor 2011, do të qëndrojnë në vizitë zyrtare në Kosovë, Grupi Britanik në Unionin Ndër-Parlamentar. Në bazë të programit të vizitës është paraparë një takim i përbashkët me anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikqyrje të Financave Publike të Kuvendit të Kosovës, ditën e mërkurë, datë 16 nëntor, ora 09:30-10:30.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu